

20232193821

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА

Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.302/20), ministri i Ekonomisë miratoi

### **R R E G U L L O R E** **PËR MËNYRËN E NJOFTIMIT, SI DHE MËNYRËN, KRITERET DHE METODAT PËR** **VLERËSIMIN E RREZIKUT NGA PRODHUESIT DHE SHPËRNDARËSIT DHE FORMËN DHE** **PËRMBAJTJEN E FORMULARIT PËR NJOFTIM PËR PRODUKTET E RREZIKSHME TË** **HEDHURA NË TREG NGA PRODHUESIT DHE** **SHPËRNDARËSIT(\*)**

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e njoftimit, si dhe mënyra, kriteret dhe metodat për vlerësimin e rrezikut nga prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe forma dhe përmbajtja e formularit të njoftimit për produktet e rrezikshme të hedhura në treg nga prodhuesit dhe shpërndarësit.

#### Neni 2

Njoftimi bëhet në rast rreziku që rezulton nga produkti që përdoret ose për të cilin ka interes nga konsumatorët, duke përfshirë produktet e përdorura të furnizuara me qëllim të kryerjes së një shërbimi, si dhe produktet për të cilat me rregullore të veçanta janë përcaktuar kërkesat për sigurinë e tyre, nëse këto rregullore nuk përmbajnë procedura për njoftim për produkte të rrezikshme.

#### Neni 3

(1) Njoftimi për produkte të rrezikshme të hedhura në treg nga prodhuesit dhe shpërndarësit (në tekstin e mëtejshëm: njoftim) dorëzohet në formular në formatin A4 në letër të bardhë.

(2) Forma dhe përmbajtja e formularit të njoftimit të përmendur nga paragrafi (1) i këtij neni janë dhënë në Shtojcën 1, që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

#### Neni 4

(1) Njoftimi i dorëzohet Ministrisë së Ekonomisë - Inspektoratit Shtetëror të Tregut (në tekstin e mëtejshëm: Inspektorati Shtetëror i Tregut) nëpërmjet sistemit të shkëmbimit të shpejtë të informacioneve, arkivit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut ose në formën e dokumentit elektronik nëpërmjet dorëzimit të rekomanduar të kualifikuar elektronik në adresën elektronike drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Tregut, në përputhje me rregulloret në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale menjëherë, e jo më vonë se tre ditë nga dita e mësimit për ekzistencën e rrezikut.

(2) Në rast se njoftimi lidhet me produkte ose grup produktesh që përbëjnë rrezik, ndërsa janë përcaktuar me rregullore të veçanta që përcaktojnë kërkesat për sigurinë e tyre dhe me rregullore të veçanta për substancat kimike, prodhuesit dhe shpërndarësit, duhet t'u dorëzojnë njoftim organeve kompetente për mbikëqyrje të tregut që kryejnë mbikëqyrjen inspektuese e rregulloreve të njëjta, nëpërmjet sistemit për shkëmbimin e shpejtë të informacioneve, për produktet që paraqesin rrezik.

---

\* Me këtë rregullore bëhet harmonizimi me Direktivës 2001/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, më 3 dhjetor të vitit 2001, Për sigurinë e përgjithshme të produkteve" (CELEX nr. 32001L0095).

#### Neni 5

(1) Prodhuesit dhe shpërndarësit nuk duhet të prolongojnë njoftimin edhe nëse një pjesë e të dhënave nuk u janë në dispozicion.

(2) Të dhënat nga pjesët 1, 2, 3, 4 dhe 5 nga formulari nga Shtojca 1 e kësaj rregulloreje, prodhuesit dhe shpërndarësit duhet t'i dorëzojnë në afatin nga neni 4 paragrafi (1) i kësaj rregulloreje, ndërsa të dhënat nga pjesa 6 e formularit nga Shtojca 1 e kësaj rregulloreje duhet t'i dorëzojnë jo më vonë se pesë ditë nga data e mësimit për ekzistencën e rrezikut.

(3) Nëse përdorimi i produktit paraqet rrezik serioz, prodhuesit dhe shpërndarësit duhet t'i dorëzojnë menjëherë të dhënat nga pjesa 6 e formularit nga Shtojca 1 e kësaj rregulloreje, ose më së voni brenda afatit nga neni 4 paragrafi (1) i kësaj rregulloreje.

(4) Në raste urgjente, si dhe kur prodhuesit dhe shpërndarësit ndërmarrin masa përkatëse korrigjuese, respektivisht parandaluese, si masa për kthimin ose tërheqjen e produktit, për ndërmarrjen e të njëjtave ata i informojnë menjëherë Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe organet kompetente të mbikëqyrjes së tregut dhe përmes sistemit të shkëmbimit të shpejtë të informacioneve, për produktet që paraqesin rrezik ose dorëzimit të rekomanduar të kualifikuar elektronik në adresën elektronike drejtuar Inspektoratin Shtetëror të Tregut.

#### Neni 6

(1) Prodhuesi që e njofton i pari Inspektoratin Shtetëror të Tregut se produkti është i rrezikshëm, duhet të dorëzojë menjëherë kopje të njoftimit tek shpërndarësit e atij produkti.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, shpërndarësit duhet të dorëzojnë menjëherë kopje të njoftimit tek të gjithë tregtarët me pakicë të cilëve ua kanë dërguar atë produkt.

(3) Shpërndarësi, i cili njofton i pari Inspektoratin Shtetëror të Tregut se produkti është i rrezikshëm, duhet të dorëzojë menjëherë kopje të njoftimit tek prodhuesi dhe tek të gjithë tregtarët me pakicë, të cilëve u ka dërguar atë produkt.

(4) Prodhuesi që merr kopje të njoftimit nga një shpërndarës duhet t'i dorëzojë Inspektoratit Shtetëror të Tregut të gjitha të dhënat në dispozicion të tij, nëse ato kanë të bëjnë me produktin e rrezikshëm, e në veçanti listën e shpërndarësve të tjerë, të cilëve ua ka dhënë/dorëzuar atë produkt për të përcaktuar përcjellshmërinë e produktit.

#### Neni 7

(1) Nëse organet kompetente për mbikëqyrje të tregut ose organet për mbikëqyrje të tregut, kompetenca e të cilave rregullohet me rregullore të veçanta, u janë dorëzuar të gjitha të dhënat e nevojshme për produktin e rrezikshëm, ato mund të kërkojnë informacione shtesë për produktin e rrezikshëm nga prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe të urdhërojnë ndërmarrjen e masave ose aktiviteteve shtesë.

(2) Bazuar në të dhënat nga njoftimi, Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe organet për mbikëqyrjen e tregut nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'u kërkojnë prodhuesve dhe shpërndarësve të monitorojnë tregun ose të informojnë opinionin për produktin, në varësi të natyrës së rrezikut dhe masave që ndërmerren.

(3) Prodhuesi dhe/ose shpërndarësi, me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Tregut dhe organeve për mbikëqyrje të tregut nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të sigurojnë inspektimin dhe/ose të dorëzojnë:

1) dokumentacion për produktin, certifikatat e testeve dhe dokumentacionin tjetër përkatës që mundëson vlerësimin e rrezikut të produktit; dhe

2) kopje falas të produkteve për testim, veçanërisht produkteve që kanë shkaktuar dëme.

#### Neni 8

(1) Për të vlerësuar seriozitetin e rrezikut, prodhuesit dhe shpërndarësit duhet të marrin parasysh kriteret si vijon:

1) rëndësinë e rrezikut që mund të rezultojë si rezultat, në varësi të seriozitetit dhe mundësinë e dëmeve të mundshme ndaj shëndetit ose sigurisë që mund të shkaktohen;

2) mundësinë e dëmtimit të zakonshëm dhe real të shëndetit ose sigurisë së konsumatorit mesatar, të ekspozuar ndaj përdorimit përkatës të produktit, si dhe mundësinë e paraqitjes së mangësisë të produkti;

3) mundësinë e dëmtimit nga produkti i rrezikshëm ndaj produkteve të tjera në treg ose ndaj një numri të madh konsumatorësh, veçanërisht për shkak të përcaktimit të llojit të aktivitetit që është e nevojshme të ndërmerret për parandalimin e shfaqjes së tij;

4) nëse rreziku është evident dhe i domosdoshëm për funksionimin e produktit, si dhe nëse prodhuesi ka ndërmarrë kujdesin përkatës me qëllim që të paralajmërojë rrezikun, veçanërisht nëse rreziku nuk është evident;

5) moshën e konsumatorit (fëmijët dhe personat e moshuar), si dhe nëse produkti ka paralajmërim përkatës dhe klauzola të sigurisë kur rreziku është evident.

(2) Për shkak të mbledhjes së të dhënave për të vlerësuar rrezikun që mund të paraqesë produkti, prodhuesit dhe shpërndarësit mund të përdorin metodat si vijon:

- njoftime dhe informacione të tjera për aksidente të lidhura me produktet;
- ankesat e konsumatorëve që kanë të bëjnë me sigurinë e produktit;
- kërkesat nga kompanitë e sigurimeve (sigurimet) në lidhje me dëmet e shkaktuara nga produktet e rrezikshme;

- mospërmbushja e kërkesave të sigurisë që prodhuesi i ka përcaktuar gjatë zbatimit të procedurës për kontrollin e cilësisë;

- të dhëna të tjera që lidhen me mospërmbushjen e kërkesave të sigurisë, të furnizuara nga organet kompetente për mbikëqyrjen e tregut, organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve ose persona të tjerë juridikë dhe fizikë që hedhin dhe/ose kanë hedhur produkt në treg dhe

- informacione në lidhje me arritjet shkencore të lidhura me sigurinë e produktit.

(3) Gjatë vlerësimit të rrezikut, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, respektivisht gjatë plotësimit të njoftimit nga neni 3 i kësaj rregulloreje, prodhuesit dhe shpërndarësit do të përdorin udhëzimet për vlerësimin dhe valorizimin e rrezikut për produktet që paraqesin rrezik për konsumatorët, të dhëna në shtojcën 2, që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

#### Neni 9

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për njoftim për produkte të rrezikshme të hedhura në treg nga prodhuesit dhe shpërndarësit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.89/07).

#### Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 25-3392/4

12.10.2023

Shkup

Ministri i Ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi**, d.v.

**Shtojca 1**

**DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË - INSPEKTORATIT SHETËROR TË TREGUT**

**Njoftim për produkte të rrezikshme të hedhura në treg nga prodhuesit dhe shpërndarësit**

<b>Pjesa 1: Të dhënat për Inspektoratin Shtetëror të Tregut (*1)</b>	
Personi i kontaktit/ adresa/telefoni/faksi/e-maili/ueb-faqja	
<b>Pjesa 2: Të dhënat për prodhuesit/shpërndarësit (*2)</b>	
Emërtimi dhe selia e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar ose përfaqësuesit të prodhuesit ose importuesit/shpërndarësit që plotëson formularin	
Personi i kontaktit/ funksioni/ adresa/ telefoni/faksi/ emaili	
<b>Pjesa 3: Të dhënat për produktin e rrezikshëm (*3)</b>	
Lloji i produktit/shenja (vula) mbrojtëse / marka tregtare/ emri i modelit/bar-kodi /vendi i origjinës	
Përshkrimi/fotografia	
<b>Pjesa 4: Të dhënat për rrezikun (*4)</b>	
Përshkrimi i rrezikut dhe mundësisë së rrezikimit të shëndetit/sigurisë dhe rezultatet e vlerësimit dhe valorizimit të kryer të rrezikut	
Të dhënat për aksidentet	
<b>Pjesa 5: Të dhëna për aktivitetet e ndërmarra (*5)</b>	
Lloji/ fushëveprimi/ kohëzgjatja e aktivitetit dhe të dhënat për personin juridik ose fizik që ka ndërmarrë aktivitetin	
<b>Pjesa 6: Të dhëna për personat e tjerë juridikë dhe fizikë në zinxhirin e furnizimit (*6)</b>	
Lista e prodhuesve, importuesve ose përfaqësuesve të autorizuar (emërtimi/ adresa/ telefoni/faksi/emaili/ ueb faqja)	
Lista e shpërndarësve ose tregtarëve me pakicë (emërtimi/adresa/ telefoni/faksi/emaili/ueb faqja)	
Numri i produkteve (numrat serialë ose data) që do të gjenden te prodhuesi/përfaqësuesi i autorizuar/përfaqësuesi/ importuesi/shpërndarësi/tregtari me shumicë/tregtari me pakicë/ konsumatori	

Më.....viti 20.... .....Shkup	Nënshkrimi i personit përgjegjës nga prodhuesi ose shpërndarësi që e dorëzon njoftimin (v.v.)
----------------------------------	--

(\*1) Shënohen të dhënat që i ka në dispozicion parashtruesi i njoftimit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut edhe atë për: personin e kontaktit/ adresën/telefonin/faksin/emailin/ueb faqen.

(\*2) Shënohen të dhënat për personin juridik që dorëzon njoftimin në Inspektoratin Shtetëror të Tregut dhe rolin e tij në procesin e hedhjes së produktit në qarkullim.

(\*3) Shënohen të dhënat për produktin dhe vendoset një fotografi e tij.

(\*4) Shënohen të dhënat për llojin dhe natyrën e rrezikut, duke përfshirë të dhënat për aksidentet e mundshme dhe ndikimet e përcaktuara ndaj shëndetit ose sigurisë. Shënohen edhe rezultatet e testeve të kryera dhe merren parasysh udhëzimet për vlerësimin dhe valorizimin e rrezikut për produktet që përbëjnë rrezik për konsumatorët, nga neni 8, paragrafi (3) me këtë rregullore.

(\*5) Shënohen të dhënat për aktivitetet e ndërmarra ose të planifikuara për të parandaluar ose eliminuar rrezikun për konsumatorët (p.sh. ndërprerje e dorëzimit, kthimin ose tërheqjen e produktit, ndryshimin e produktit, njoftimin e konsumatorëve) dhe të dhënat për personin juridik ose fizik që ka ndërmarrë aktivitetin në fjalë.

(\*6) Shënohen të dhënat për personat e tjerë juridikë dhe fizikë në zinxhirin e furnizimit që kanë produktin e rrezikshëm në rezervë. Njëherësh, shënohen edhe të dhëna për numrin e përafërt të produkteve që gjenden tek prodhuesi/ përfaqësuesi i autorizuar/përfaqësuesi/ importuesi/ shpërndarësi/tregtari me shumicë/ tregtari me pakicë/ konsumatori.

## Shtojca 2

### Udhëzime për vlerësimin dhe valorizimin e rrezikut për produktet që paraqesin rrezik për konsumatorët

#### Korniza metodologjike për lehtësimin e vlerësimit dhe evaluimit të saktë të rrezikut

Këto udhëzime përdoren për të ndihmuar prodhuesit dhe shpërndarësit gjatë vlerësimit të nivelit të rrezikut dhe vendimmarrjes nëse njoftimi i organeve kompetente është i domosdoshëm. Subjektet ekonomike duhet të vlerësojnë në secilin rast individual në bazë të gjendjes faktike, duke marrë parasysh kriteret e parashikuara në këtë rregullore, përvojën dhe praktikën e tyre të mëparshme, si dhe konsideratat e tjera relevante dhe metodat përkatëse.

Produkti që është i dedikuar për konsumatorët ose përdoruesit e tjerë mund të paraqesë rrezik në një ose më shumë mënyra. Rreziku mund të jetë i llojeve të ndryshme (kimik, mekanik, elektrik, termik, rrezatues, etj.). Rreziku paraqet potencialin natyror të produktit për të dëmtuar shëndetin dhe sigurinë e përdoruesit në rrethana të caktuara. Serioziteti i çdo lloji të veçantë të rrezikut mund të renditet duke përdorur kriteret cilësore, e nganjëherë edhe sasore që lidhen me llojin e dëmit që mund të shkaktohet.

Mund të ndodhë që jo të gjitha produktet individuale të paraqesin rrezik, por vetëm disa nga produktet që janë vendosur në treg. Rreziku mund të lidhet me një parregullsi që shfaqet vetëm në disa produkte të llojit të caktuar (markë tregtare/e mallit, etj.) që janë hedhur në treg. Në raste të tilla, duhet të merret parasysh mundësia e pranisë së parregullsive/rreziqeve që lidhen me produktin.

Potenciali që të realizohet rreziku si ndikim real negativ në shëndetin/sigurinë do të varet nga shkalla në të cilën konsumatori është i ekspozuar ndaj rrezikut derisa e përdorë produktin në përputhje me dedikimin e tij ose siç mund të pritët në mënyrë të arsyeshme gjatë jetëgjatësisë së produktit.

Ekspozimi ndaj një rreziku të veçantë, në disa raste, mund të lidhet me shumë njerëz në të njëjtën kohë. Gjatë përcaktimit të shkallës së rrezikut të paraqitur nga produkti duke kombinuar seriozitetin e rrezikut dhe ekspozimit, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe aftësisë së konsumatorit që është i ekspozuar ndaj rrezikut për të parandaluar ose reaguar ndaj situatës së rrezikshme, që varet nga dëshmia për ekzistimin e rrezikut, paralajmërimet e dhëna dhe cenueshmërinë e konsumatorit që mund të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut.

Duke marrë parasysh sa më sipër, qasja e radhës ndihmon subjektet ekonomike gjatë vendimmarrjes nëse një situatë specifike e rrezikshme e shkaktuar nga produkti tregon për në nevojën për udhëzim për njoftim tek organet për mbikëqyrjen e tregut.

Rekomandohet që vlerësimi të kryhet nga një ekip i vogël profesional që zotëron njohuri dhe përvojë për produktin dhe rreziqet e tij. Vlerësuesit duhet të marrin vendime subjektive nëse të dhënat objektive nuk janë të disponueshme dhe besohet se kjo procedurë do t'u ndihmojë që të marrin vendime të sakta dhe të arsyeshme për rreziqet aktuale dhe të mundshme.

Vlerësuesi duhet t'i analizojë informacionet e siguruar dhe të përdorë tabelën e vlerësimit të rrezikut në mënyrën si më poshtë:

1. Si hap i parë, përdoret Tabela A për të përcaktuar peshën e rezultatit të rrezikut, në varësi të seriozitetit dhe probabilitetit të dëmtimit që ndodh në kushtet e përdorimit dhe mundësinë e ndikimit të shëndetit/sigurisë në lidhje me karakteristikat thelbësore të rrezikshme të produktit;
2. Si hap i dytë, përdoret Tabela B për të vlerësuar më tej peshën e rezultatit në varësi të llojit të konsumatorit. Për personat e rritur e parrezikuar, keni parasysh rrethanën nëse produkti shoqërohet me paralajmërimet përkatëse dhe masa mbrojtëse dhe nëse rreziku është mjaft evident për të mundësuar vlerësim cilësor të rrezikut.

### **Tabela A – Vlerësimi i rrezikut: Pesha dhe probabiliteti i shkaktimit të dëmit ndaj shëndetit/sigurisë**

Në Tabelën A kombinohen dy faktorët kryesorë që ndikojnë në vlerësimin e rrezikut, më së shumti pesha dhe propabiliteti i shkaktimit të dëmit.

#### **Serioziteti/pesha e lëndimit**

Vlerësimi i seriozitetit të lëndimit bazohet në analizën e pasojave potenciale nga rreziku i produktit konkret ndaj shëndetit/sigurisë. Vlerësimi duhet të përcaktohet për çdo lloj individual të rrezikut.<sup>1</sup>

Vlerësimi i seriozitetit në të njëjtën kohë duhet të marrë parasysh numrin e personave që mund të rrezikohen nga produkti i rrezikshëm. Kjo do të thotë se një rrezik që mund të rrezikojë më shumë se një person (p.sh. zjarri ose helmimi me gaz nga aparati i gazit) duhet të klasifikohet si rrezik më i rëndë se ai që mund të rrezikojë vetëm një person.

Vlerësimi fillestar i rrezikut duhet të lidhet një rrezik që kërcënon çdo person të ekspozuar ndaj produktit dhe në të njëjtin duhet të ndikojë numri i popullatës së rrezikuar. Por, për organet kompetente mund të jetë e rëndësishme subjektet ekonomike të marrin parasysh edhe numrin e përgjithshëm të personave të ekspozuar ndaj produktit gjatë vendimmarrjes për llojin e aktivitetit që duhet ta ndër marrin. Në shumë rreziqe, është e mundur të parashikohen rrethana më pak të mundshme që mund të çojnë në pasoja shumë serioze (p.sh. ngatërrimi i kablllove, një rënie dhe dëmtim në kokë që çon në vdekje), megjithëse ka epilog më pak serioz është më pak i mundshëm. Vlerësimi i seriozitetit duhet të bazohet në dëshmi të arsyeshme se pasojat që janë përzgjedhur si karakteristike për rrezikun, mund të shkaktohen gjatë përdorimit të parashikuar. Kjo mund të jetë përvojë në rastin më të keq, duke marrë parasysh (dhe duke krahasuar) produkte të ngjashme.

#### **Probabiliteti i përgjithshëm**

Probabiliteti i përgjithshëm i referohet probabilitetit të efekteve negative ndaj shëndetit/sigurisë së personit të ekspozuar ndaj ngjarjes negative/të dëmshme. Me këtë rast, kriteri nuk e merr parasysh numrin e përgjithshëm të personave që janë në rrezik.

Atje ku udhëzuesi tregon mundësinë e parregullsisë së një produkti, ky komponent nuk do të zbatohet nëse është e mundur të identifikohet çdo kopje e dëmtuar e produktit. Në situatë të tillë, përdoruesit e produkteve të gabuara janë të ekspozuar ndaj rrezikut të plotë, ndërsa përdoruesit e produkteve të tjera nuk janë të ekspozuar ndaj rrezikut fare. Probabiliteti i përgjithshëm është kombinim i të gjitha probabiliteteve kontribuese, respektivisht:

- probabiliteti që produkti të jetë ose të bëhet i parregullt (nëse të gjitha produktet kanë një mangësi, atëherë ky probabilitet është 100%);
- probabiliteti i shkaktimit të ndikimit negativ për çdo përdorues mesatar i cili është i ekspozuar ndaj përdorimit të qëllimshëm ose të arsyeshëm të pritur të produktit me mangësi.

<sup>1</sup> Për shembull, për rreziqe të caktuara mekanike, mund të propozohen klasifikimet si vijon të seriozitetit të lëndimit, me lëndime tipike përkatëse:

Lëndim i lehtë	Lëndim i rëndë	Lëndim shumë i rëndë
<2% paaftësim, zakonisht i shërueshëm dhe për të cilin nuk nevojitet trajtim spitalor	2-15 paaftësim, zakonisht i pashërueshëm, nevojitet trajtim spitalor.	>15% paaftësim, zakonisht i pashërueshëm, nevojitet trajtim spitalor
Prerje më të vogla	Prerje serioze	Lëndime serioze të organeve të brendshme
Fraktura më të vogla	Gisht i humbur i dorës ose i këmbës	Humbje e krahut ose këmbës
	Dëmtim i shikimit	Humbja e shikimit
	Dëmtim i dëgjimit	Humbja e dëgjimit

Këto dy probabilitete kombinohen në tabelën si vijon me çka fitohet probabiliteti i përgjithshëm që është paraqitur në Tabelën A.

Probabiliteti i përgjithshme për dëmtim të shëndetit/sigurisë		Probabiliteti për produkt të rrezikshëm		
		1%	10%	100%
Probabiliteti i dëmtimit të shëndetit/sigurisë nga ekspozimi i rregullt ndaj produktit të rrezikshëm	Rreziku është gjithmonë i pranishëm dhe ekziston mundësia që dëmtimi i shëndetit/sigurisë të ndodhë <b>me përdorimin e parashikuar</b>	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë
	Rrezik që mund të ndodhë nën një rrethanë të <b>pamundur</b> ose kombinim të dy rrethanave të mundshme.	I ulët	Mesatar	I lartë
	Rrezik që shfaqet vetëm nëse plotësohen disa rrethana të <b>pamundura</b> .	Shumë i ulët	I ulët	Mesatar

Kombinimi i seriozitetit të lëndimit dhe probabilitetit të përgjithshëm në Tabelën A jep vlerësimin e shkallës së rrezikut. Saktësia e këtij vlerësimi do të varet nga cilësia e informacioneve që janë në dispozicion të subjektit ekonomik. Por, ky vlerësim duhet të modifikohet në mënyrë të tillë që do të marrë parasysh perceptimin shoqëror për pranueshmërinë e rrezikut. Shoqëria pranon rreziqe shumë më të larta në disa rrethana, siç është motoçiklizmi, sesa në të tjerat, siç janë lodrat për fëmijë. Tabela B përdoret për përfshirjen e këtij subjekti.

**Tabela B – Klasifikimi i rrezikut: lloji i personave, njohuri për rrezikun dhe masat e kujdesit**

Shoqëria në disa rrethana përfshin rreziqe më të larta se në të tjerat. Konsiderohet se faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut janë cenueshmëria e shikimit të personit të prekur, ndërsa për personat e rriturit të parrezikuar, njohuria për rrezikun dhe mundësia e ndërmarrjes së masave parandaluese për shkak të parandalimit të të njëjtit.

### Personat e rrezikuar

Është e nevojshme të merret parasysh lloji i personit që do të përdorë produktin. Nëse ka të ngjarë që produkti të përdoret nga persona të rrezikuar, niveli i rrezikut duhet të jetë në nivelin më të ulët të rrezikut (rreziku minimal i produktit). Në tabelën e radhës janë propozuar dy kategori të personave të rrezikuar, me shembuj:

Personat shumë të rrezikuar	Personat e rrezikuar
Personat e verbër	Personat me shikim të dëmtuar
Personat me invaliditet të rëndë	Personat me dëmtim të pjesshëm
Shumë persona të vjetër	Persona më të moshuar
Shumë të rinj (më të rinj se 3 vjeç)	Të rinj (3 – 11 vjeç)

### Personat e rritur të parrezikuar

Përshtatja e seriozitetit të rrezikut tek personat e rriturit të parrezikuar duhet të zbatohet vetëm nëse rreziku është evident dhe i domosdoshëm për funksionalitetin e produktit. Për personat e rritur të parrezikuar, niveli i rrezikut do të varet nga rrethanat nëse rreziku është evident dhe nëse prodhuesi ka ndërmarrë kujdesin e duhur për ta bërë produktin të sigurt dhe për të siguruar mbrojtje dhe paralajmërime, veçanërisht nëse rreziku nuk është evident. Për shembull, nëse produkti ka paralajmërime dhe mbrojtje adekuate dhe rreziku është evident, shkalla e lartë e epilogut mund të mos jetë serioz në aspektin e vlerësimit të rrezikut (Tabela B), megjithëse veprimet individuale mund të jenë të domosdoshme për shkak të përmirësimit të sigurisë së produktit. E kundërta e kësaj, nëse produkti nuk është i siguruar me masa prëkatëse mbrojtëse dhe paralajmërime, e rreziku nuk është evident, një shkallë e moderuar e epilogut është serioz në aspektin e vlerësimit të rrezikut (Tabela B).

### Vlerësimi i rrezikut për produktet e konsumit

Këto udhëzime duhet të ndihmojnë bizneset gjatë vendimmarrjes nëse për një situatë specifike të rrezikshme të shkaktuar nga produkt i konsumit është i nevojshëm njoftimi i Inspektoratit Shtetëror të Tregut.

